



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 628/ Prot.

Durrës, më 17.02 .2025

VENDIM

Nr. 10 , datë 17.02 .2025

PËR

**"MIRATIMIN E REDUKTIMIT TË TARIFËS SË STUDIMIT NË PROGRAMIN E
CIKLIT TË TRETË "DOKTORATË NË E DREJTË PUBLIKE" NË
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*"; nenit 34 pika 1 gërma I të Statutit të UAMD-së; të Rregullores së UAMD-së; në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike me Nr. 487 Prot, datë 05.02.2025, vendimit të Senatit Akademik nr. 7, datë 10.02.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e reduktimit të tarifës vjetore të studimit me 70% (brenda kohës normale të studimeve) për studentët doktorantë të cilët janë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë ose personelit administrativ me kohë të plotë në UAMD, dhe vazhdojnë programin e studimit Doktoratë në "E Drejtë Publike" pranë Fakultetit të Shkencave Politike Juridike.
2. Ky reduktim do të përfitohet mbi kushtet e përcaktuara të një marrëveshje tip të nënshkruar mes studentit doktorant dhe UAMD
3. Studentit doktorant jashtë kohës normale të studimeve i lind detyrimi për pagesën e plotë të tarifës vjetore të studimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

